

VENDIM
Nr.310, datë 25.3.2009

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2009, PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 16 e 5, paragrafi i katërt, i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, në programin “Mbështetje për energjinë”, zëri “Transferta”, t’i shtohet fondi prej 392 241 847.7 (treqind e nëntëdhjetë e dy milionë e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e dyzet e shtatë pikë shtatë) lekësh, si transfertë, shoqërisë me kapital 100 për qind shtetëror, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., në formën e huasë, për realizimin e projektit “Ndërtimi i nënstacionit 110/40 KV, me fuqi 2 x 5.6 MVA, Tuneli i Kalimashit dhe e një daljeje linje 110 KV, në nënstacionin ekzistues 110/6 KV, Kalimash”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, i miratuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2009.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha